



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3104 / Prot.
2

Tiranë, më 24 . 12 .2020

VENDIM

Nr. 46 , datë 23 . 12 .2020

Për riorganizimin e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Përkatësi Gjinore dhe Zhvillim" në Master i Shkencave në " Diversiteti, Mundësitë e Barabarta dhe Përfshirja Sociale" në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT"

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, germa b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, germa "dh"; neni 75; Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV, germa "B"; Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa "f" si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresën Nr. 781/1 Prot., datë 27.10.2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 23.12.2020;

VENDOSI:

1. Të riorganizojë programin e ciklit të dytë të studimeve nga "Master i Shkencave" në "Përkatësi Gjinore dhe Zhvillim", në "Master i Shkencave" "**Diversiteti, Mundësitë e Barabarta dhe Përfshirja Sociale**" në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" "Diversiteti, Mundësitë e Barabarta dhe Përfshirja Sociale", të Fakultetit të Shkencave Sociale të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t'i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha
TIRANË